

KUVENDI I IX MBARËBREGDETAR VENDOS PRIORITET I SHOQATËS 'BREGDETI' - KTHIMI FIZIK I PRONAVE, PRONARËVE TË LIGJSHËM

Niko Nesturi, Kryetar i Shoqatës Bregdeti

Kuvendi i IX mbarëbregdetar i Shoqatës 'Bregdeti' mbledhur në fshatin Gjilek-Dhërmi në datën 08.08.2010 diskutoi çështjen e shkëljes së pronësisë mbi tokën nga ana e Shtetit. Kuvendi i rikujton kryeministrin, Qeverisë dhe Presidentit të Republikës se Kushtetuta vazhdon të shkelet në çdo hap të veprimtarisë së administratës shtetërore me pronat dhe situata tashmë alarmante kërkon shpjegim dhe zgjidhje me precedence! **Prioritet i shoqatës 'Bregdeti' është kthimi fizik i pronave!**

E drejta e pronës private të trashëguar mbi tokën është nëpërkëmbur sistematikisht gjate 19 viteve pluralizëm, duke mohuar një nga shtyllat themelore të të drejtave të njeriut, duke shkaktuar dëme serioze dhe duke mbajtur pezull investimet vendase dhe të huaja. **Kthimi fizik i tokës pronarëve të trashëgimtarëve të ligjshëm bregdetas, prona të trashëguara brez pas brezi është detyrim kushtetues për Qeverinë.** Familjet e shpronësuara nga regjimi i diktaturës, duhet ta kishim marrë këtë pronë menjëherë pas ndërrimit të sistemeve në 1991, ashtu si e gjithë Shqipëria e veriut dhe 75% e vendit. Qeverite kanë privilegjuar grabitësit e tokave dhe kanë diskriminuar pronaret e vërtetë, duke i quajtur ish-pronarë për ta rezervuar për veten e tyre emrin pronarë. Qeveria Shqiptare i ka edhe sot të gjitha mundësitë për tua kthyer fizikisht tokën trashëgimtareve të ligjshëm të pronarëve të shpronësuar nga diktatura, por atë e komandon babëzia dhe nxiton të ngatërrojë dhe të mbylli për 45 ditë legalizimet dhe privatizimet e truallit që duhet ti kthehet të zotit. **Kompesimi i tokës së grabitur në shumicën e rasteve kur toka mund ti kthehet të zotit, është jo vetëm antikushtetues por është farsë që financiarisht kurrë nuk mund të realizohet.** Këtë kompensim apo një tjetër kompensim Qeveritarët le tu japin atyre që kanë shfrytëzuar padrejtësisht për 19 vjet pronat tona dhe pronarit ti kthehet fizikisht prona e tij!

Ne besojmë se institucionet ndërkombëtar dhe protestat e popullit, që po bëhet faktor për zgjidhjen e problemit do ta ndihmojnë Kryeministrin dhe Qeverinë të analizojë dhe korrigjojnë pozicionin e gabuar antipronar dhe anti Bregdet, që po vazhdon prej 19 vjetësh.

Vetëm duke kthyer fizikisht pronën tek i zoti i jepet fund anarkisë, pasigurisë sociale, frenimit të zhvillimit ekonomik dhe parandalimin e konflikteve për pronën. Pa kthyer pronën tek i zoti nuk ka zhvillim të industrisë turistike. Dukati dhe Kakomeja janë shembuj të freskët që nuk mund të shumëzohen me zero. Bregasit e kanë bërë mendjen top për ta zgjidhur çështjen e pronësisë që trashëgojmë nga të parët sepse: Na pëlqen zgjidhja që bënë patriotët tanë veriore, duke shkuar secili në tokën e trashëguar, prandaj kemi vendosur të kopjojmë përvojën e tyre.

Në një shtet ligjor nuk mund të zbatohen dy standarde dhe veprimtaria shtetërore duhet ta respektojë të drejtën e pronës dhe nuk mund të shkelë kushtetutën. Edhe ne jemi si ata zonë kodrinore malore. Nuk ka pse ne zonat turistike bregdetare të zbatohet një standard tjetër nga zonat turistike të veriut. Ne kemi shumë djem e vajza që punojnë me vite në sektorin e turizmit në emigracion tek fqinjët tanë dhe ka ardhur koha që ata të punojnë në tokat e tyre, në atdheun e tyre. Mjaft më I shfrytëzuan pushtetarët pronat tona.

Ne si shoqatë dhe degët e shumë fshatrave kemi siguruar **bashkepunim me pushtetin vendor**, dhe secili është i angazhuar për ta zgjidhur siç duhet çështjen e pronësise, duke kaluar tokën sipas kufijve të parakolektivizimit komunist tek trashëgimtarët ligjore. **Kthimi i pronës në origjinë nxjerr jashtë loje mekanizmat e politikaneve mafioze dhe ju mbyll atyre të gjitha shtigjet e hapura deri tani nga anarkia e pronës.**

Mekanizmat e anarkisë së pronës fillojnë në 1991 me ligjin 7501, dhe xhepat e tij. Më vonë pushtetarët grabitën troje turistike me aplikimin e “personave të stimuluar”, me ALUIZININ me privatizimet e AKP, me lloj lloj vendimesh të Këshillit të Ministrave. Fjala deputet në kohën e tranzicionit po bëhet fjalë turpi, një lloj si fjala komunist në vitet 1990-91, për faktin se mbi 20 amendime të variantit fillestar të ligjit 7501 dhe të gjitha përshkohen me kujdesin e rafinuar të kusarit dhe të Katovicës, që prona të mos ti kthehet familjes së të shpronësuar. Për këtë arsye pronari, në ligjet dhe në fjalorin e politikanëve të Katovicës është emërtuar ish-pronar dhe mashtrohet dhe shtyhet me fjalët kompensim. Kryetarët e komisioneve dhe të Agjensive që kanë vledhur sipërfaqe të mëdha pas një viti pushohen nga puna për abuzim. Ata dërgohen në një punë më të mirë ose ambasadorë ose u jepen dënime fiktive, por aktet që konstatohen se janë në shkelje me ligjin nuk anulohen dhe pronat e vjedhura nuk i kthehen menjëherë të zotit.

Është fakt se **bregdetasit për të shmangur vetgjqësinë, prej 19 vetësh presin ligjin për kthimin e pronës tek i zoti**, por pushtetarët kanë bërë lloj-lloj mekanizmash, komisionesh dhe ligjesh të ngatërruara e kontradiktore që sabotojnë kthimin fizik të pronës tek i zoti dhe e transferojnë atë tek vetvetja ose tek klanet e tyre. Pronarët pengohen deri sa të paguajnë nën dorë ose në natyrë që të marrin vendimin për njohjen, kthimin dhe kompensimin e pronës. Ky është realiteti i sotshëm.

Prona e zonave turistike është përvetësuar nga pushtetarët që vazhdojnë të “zhvillojnë turizmin” dhe ky është shkaku pse pronarët janë në protesta të vazhdueshme. **Situata në bregdetin Vlorë Sarandë është alarmante** për këdo që i ka sytë në ballë. Nuk kemi statistika të plota që të themi sa është numri i restoranteve dhe hoteleve që janë ndërtuar në tokat e të shpronësuarve nga të fortët e rrugës të mbështetur prej politikanëve, se janë fitimet që derdhen në xhepat e pushtetarëve që ata të mos ngacmohen dhe mundësisht të legalizohen Ndjemë dhimbje dhe keqardhje kur dëgjuam nga z. Presidenti i Parlamentit të OSBE z. Wolfgang Grossruck komentin se zhvillimi i turizmit fitohet nga më i shpejti ... Pse OSBE një nga institucionet ndërkombëtare që jep leksione për demokraci, pse Banka Botërore që me shumë të drejtë orienton se sa duhet të jenë pensionet dhe sa duhet të jetë çmimi i energjisë elektrike harrojnë dhe nuk thonë as gjysëm fjalë për domosdoshmërinë dhe imponimin që, duhet ti bëhet Qeverisë demokratike që të kthejë në origjinë pronat që ka grabitur diktatura

pararendëse, veprim që normalisht duhet ta kishte bërë që me vendimin e parë të saj. Çfarë detyrash kryejnë ambasadorët e këtyre institucioneve ndërkombëtare? Nëse Shoqata “Bregdeti” dhe shoqata “Pronësi me Drejtësi”, deri më sot ka dërguar në kancelaritë Evropiane me dhjetra peticione që janë publikuar edhe në gazetatat tona dhe përsëri problemi i pronës nuk vihet në qendër të diskutimit, atëhere merr vlerë konkluzioni i gazetarit të “Shekullit” z. Bledar Prifti që thotë: *“ tashmë mund të flitet me plot gojë se organizmat Evropiane janë viktima ose të injorancës së Politikanëve të tyre mediokër ose viktima të disa funksionarëve evropianë të sponsorizuar dhe të blerë nga qeveria”*.

Përsërim edhe një herë **apelin** që shoqata “Pronësi me Drejtësi” me 15.07.2010 i ka dërguar kancelarive dhe institucioneve ndërkombëtare demokratike dhe në 22 Korrik 2010 e ka publikuar në media ***“Sa jetë njerëzish më shumë do të duhet të vyshken për shkak të abuzimit kriminal të pronave, sa dekada më shumë abuzimi kriminal me pronen do të duhet të kalojnë, sa herë më shumë do të duhet të pasurohen abuzivisht klasa politike dhe ata që janë mbrapa tyre dhe sa herë me shumë do të duhet të rrënohet klasa e pronarëve të vërtetë e të ndershëm, esnafëve, intelektualeve, patriotëve, etj., sa më i gjatë do të duhet të jetë vargu i gjeneratave të shitblerjeve abuzive, ilegale dhe antikonstitucionale të pronave, sa më i lartë do të duhet të jete niveli i korrupsionit të ekzekutivit, gjyqësorit dhe legjislativit për shkak të abuzimeve me pronën, sa më thellë do të duhet të futen në konflikt social shqiptarët me njeri tjetrin për shkak të pronës që ju të ndërhyni për të thënë fjalën tuaj për këtë çështje kaq vitale për një komb dhe shtet?***

Historia e popullit të Bregdetit është e lashtë sa vetë historia aq sa as historianët e botës nuk e dinë me saktësi. Ne deklarojmë se koha zero për popullin tonë nuk është viti 1991. **Historia e pronës është historia e vendit**, kush e prish qoftë i mallkuar. Bregdetasit kërkojnë kthimin fizik të pronës dhe nuk mendojnë se ata bëhet pronar nga një Agjensi që pengon kthimin , se koha zero për atdheun e tyre nuk fillon në vitin 1991, kur Presidenti Ramiz Alia dhe Kuvendi i Shqipërisë me mentalitet komunist dhe demagogji pluraliste, filloi zbatimin e platformës së Katovicës. Me shumë të drejtë protesta e Dukatit filloi dhe po vazhdon me këngë patriotike dhe këtë protestë model, do ta përkrahi gjithë populli i ndershëm.